



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS

Equilibrium  
CENTER

Nr. 289 / prot.

Tiranë, më 19.02.2025

Nr. 2 / prot.

Tiranë, më 19.02.2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

*ndërmjet*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS**

*dhe*

**QENDRËS EQUILIBRIUM**

Sot më datë, 19 . 02 .2025, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

**Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës**, me Adresë: Rruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës z. Ermal Pacaj, këtu e në vijim "DPSHP",

dhe

**Qendra "Equilibrium"**, me Adresë: Rruga Ndre Mjeda, Z.K 8220, nr. 3/491+5-N2, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive e Qendrës Znj. Vitjona Begeja këtu e në vijim "Qendra".

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bien dakort për nënshkrimin e saj si më poshtë:

### **Neni 1** **Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të DPSHP dhe Qendrës për ekzekutimin e dënimeve alternative, për të siguruar mbikëqyrjen e çdo dënimi alternativ, si dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij, për personat nën mbikëqyrje, në zbatim të vendimeve të Gjykatës dhe urdhrave të Prokurorit, në kuadër të marrjes së një formimi profesional dhe ushtrimit të një profesioni të dobishëm për personat nën mbikëqyrje, kryesisht për të rinjtë.

### **Neni 2** **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin 79/2020 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", në ligjin nr. 78/2020 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit të Provës" si dhe në V.K.M nr. 421 datë 08.07.2021 "Për miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provës".

### **Neni 3** **Objekti i Marrëveshjes**

Kontributi i autoriteteve për ekzekutimin e dënimeve alternative për personat nën mbikëqyrje me qëllim mbrojtjen e interesave të këtij komuniteti, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit nën mbikëqyrje gjatë kryerjes së dënimit alternativ për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror, duke nxitur formimin profesional dhe për ti orientuar drejt punësimit.

#### **Neni 4**

#### **Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës**

1. DPSHP, me anë të degës territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, njofton Qendrën, për personat nën mbikëqyrje duke i vënë në dispozicion dokumentet përkatëse të nevojshme me anë të një letër - reference.
2. DPSHP, nëpërmjet degës territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, i shpjegon personit nën mbikëqyrje qëllimin e bashkëpunimit duke e informuar rreth llojit të formimit profesional që do të kryhet nga Qendra.
3. DPSHP, nëpërmjet degës territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, komunikon me personin përgjegjës të Qendrës, për rastin e referuar, mbi dakordësimin e periudhës së marrjes së formimit profesional.
4. Të marrë pjesë në veprimtaritë ndërgjegjësuese dhe informuese të organizuara nga Qendra me personat nën mbikëqyrje me dënime alternative mbi legjislacionin për Shërbimin e Provës dhe dënimet alternative, si dhe detyrimet që ata duhet të ndjekin gjatë kryerjes së dënimit alternativ.
5. Të ndajë me Qendrën përvojat dhe praktikat më të mira në lidhje me objektivat e përcaktuara në Marrëveshje.
6. Të marrë pjesë në takimet, diskutimet dhe konsultimet e përbashkëta me Qendrën, që kanë lidhje me dënimet alternative dhe Shërbimin e Provës.
7. Të marrë pjesë në zhvillimin e seminareve trajnuese që zhvillon Qendra me aktorë kryesorë që angazhohen në zbatimin e legjislacionit për Shërbimin e Provës dhe dënimet alternative.

#### **Neni 5**

#### **Detyrimet e Qendrës**

1. Vë në dijeni personat nën mbikëqyrje me dënime alternative për rregullat që duhen respektuar nga këta të fundit, në marrëdhënie dhe detyrimet e tyre me Qendrën.
2. Të organizojë dhe të nxisë aktivitete formuese dhe profesionale me personat nën mbikëqyrje, për të kontribuar në krijimin e mundësive humanitare, sociale, edukative dhe ekonomike të tyre.
3. Të organizojë aktivitete konsultuese me përfaqësues të Shërbimit të Provës për ngritjen e programeve të kujdesit dhe ndihmës për riintegrimin psiko-social, të të rinjve.
4. Të organizojë takime të koordinuara me përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe me personin nën mbikëqyrje, për të diskutuar rreth aktiviteteve të parashikuara në Planin Individual të Trajtimit për t'u kryer nga Qendra.
5. Zbaton Planin Individual të Trajtimit bazuar në Letër Referencën si dhe merr konsentin nga personi nën mbikëqyrje për veprimtaritë që do të kryhen duke përmendur llojin, vendin, kohën si dhe përfshirjen në veprimtari me karakter profesional, edukativ. Ky

rehabilitim do të jetë individual, në grup apo familjar.

6. Merr përsipër që në përfundim të veprimtarisë të përfshirë në Planin Individual të Trajtimit, kur personi nën mbikëqyrje të jetë përfshirë në kurse formimi profesional, të pajisë personin nën mbikëqyrje dhe degën territoriale të Shërbimit të Provës Tiranë, me një vërtetim mbi përfundimin e veprimtarisë apo ciklit të kursit të formimit profesional.
7. I raporton Shërbimit të Provës brenda 5 (pesë) ditëve kur konstaton mos përmbushje të detyrimeve përkatëse nga personi nën mbikëqyrje.
8. Të marrë pjesë aktive në takimet, diskutimet dhe konsultimet e përbashkëta me Shërbimin e Provës që kanë lidhje me dënimet alternative dhe Shërbimin e Provës.
9. Të informojë dhe komunikojë me shkrim me DPSHP për probleme apo çështje të veçanta, që mund të dalin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
10. Të kontribuojë në publikimet informuese dhe ndërgjegjësuese, që do t'u shpërndahen personave nën mbikëqyrje me dënime alternative, për legjislacionin e Shërbimit të Provës dhe dënimeve alternative.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga dita e nënshkrimit të saj.

#### **Neni 7 Personat e kontaktit**

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

**Për DPSHP:**

Z. Dritan Boçi

Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tiranë

Adresa: Rruga "Jordan Misja" Ndërtesa 6/1 Hyrja 1 Kodi Postar:  
1016

E-mail: [dritan.boci@sherbimiproves.gov.al](mailto:dritan.boci@sherbimiproves.gov.al)

**Për Qendrën Equilibrium : Znj. Vitjona Begeja**

Rruga Ndre Mjeda, Z.K 8220, nr. 3/491+5-N2, Tiranë

E-mail: [info@equilibrium-center.org](mailto:info@equilibrium-center.org)

2. Personat e caktuar në pikën 1 të këtij Neni do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.

3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.

### **Neni 8 Zbatimi i Marrëveshjes**

1. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj.
2. Për çdo problem gjatë zbatimit të Marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të rrjedhin gjatë zbatimit të saj.
3. Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

### **Neni 9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

### **Neni 10 Dispozita të fundit**

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6 të saj.
2. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
3. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR**

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË  
SHËRBIMIT TË PROVËS**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**PËR**

**QENDRËN EQUILIBRIUM**



**DREJTORESHA EKZEKUTIVE**

**Vitona Begeja**